



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.11, datë 29.05.2024

PËR
MIRATIMIN E PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE TË SHFUOIZIMIT DHE
REFUZIMIT TË LEJEVE TË ZHVILLIMIT/ NDËRTIMIT TË MIRATUARA NGA
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

Në mbështetje të neneve 27, 28, pika 1, dhe 39, të Ligjit Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9, 10/1 dhe 25 të VKM-së Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 725, datë 02.09.2015 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Territorit pasi mori në shqyrtim propozimin e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit,

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e lejeve të zhvillimit, të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi, për të gjitha rastet për të cilat është miratuar vendimi për miratimin e lejes së ndërtimit, sipas Listës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Refuzimin e aplikimeve për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi, të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi, për të gjitha rastet e refuzimit automatik nga sistemi elektronik i lejeve të ndërtimit, pasi aplikuesit nuk kanë ndjekur procedurat dhe afatet ligjore për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar nga Sekretariati teknik i KKT-së.
3. Refuzimin e aplikimeve për leje zhvillimi, të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi, për të gjitha rastet kur subjektet zhvilluese nëpërmjet deklaratave noteriale kanë kërkuar tërheqjen e aplikimeve për leje zhvillimi.
4. Sekretariati Teknik i KKT-së të marrë masat për refuzimin e aplikimeve sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA





MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË


BELINDA BALËUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 28/10 2024

1. **Vendim Nr. 27, datë 28.12.2020** “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Porti turistik dhe i shërbimeve “Marina Limion” dhe Kompleksi turistik “Marina Bay Saranda”, me vendndodhje në Bashkinë Sarandë, me subjekte zhvilluese shoqëritë “Concord Investment” sh.p.k, “Marina Limion” sh.p.k. dhe “Marina Bay Saranda” sh.p.k.
2. **Vendim Nr. 28, datë 28.12.2020** “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Resort Turistik me parkim nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Sarandë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Alb-Star” sh.p.k.
3. **Vendim Nr. 11, datë 28.12.2020** “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Ndërtimi i godinës administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, Bashkia Tiranë”, me zhvillues Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor.
4. **Vendim Nr. 20, datë 28.12.2020** “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin “Objekt me funksione komplekse, shërbimi, zyra dhe rezidenciale”, me vendndodhje Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqëritë “EB Construction” sh.p.k dhe “AgroRoma 2019” sh.p.k.
5. **Vendim Nr. 06, datë 17.05.2019** “Për miratimin Lejes së Zhvillimit për objektin: “Aeroporti i Kukësit, Bashkia Kukës”, me propozim të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
6. **Vendim Nr. 19, datë 17.03.2021** “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Korpusi Avokatia me 3 dhe 5 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë me mur rrethues”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me zhvillues Dhomën Kombëtare të Avokatisë.
7. **Vendim Nr.27, datë 01.08.2023** “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Godinë polifunkionale”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Fusha” sh.p.k.

